



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2022:126404

Datë: 26.03.2024

Numri i dokumentit: 05506163

P.nr.621/2022

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, gjyqtari i vetëm gjykues Refki Piraj, me bashkëpunëtoren profesionale Arbnijë Gashi, në lëndën penale kundër të pandehurit N. (Ç.)V. nga Prizreni, rrugën "N." nr....., i akuzuar sipas aktakuzës PP/II.nr.264-13/22 të dt.20.06.2022, për shkak të veprës penale, Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1 të KPRK-së, me datë 26.03.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET marrëveshja për ndërmjetësim e lidhur në mes dëmtuarës KEDS-Distrikti në Prizren dhe të pandehurit N. (Ç.)V.. me numër personal, nga i ati Ç., e ëma H., i lindur me datë, nga Prizreni, i martuar, në Qendrën e Ndërmjetësimit në Prizren nr. ref. Ndm.86/2024 të datës 06.03.2024.

HUDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore në Prizren PP/II.nr.264-13/22 të dt.20.06.2022, dhe **PUSHOHET** procedura penale ndaj të pandehurit N. (Ç.)V., nga Prizreni.

Shpenzimet e procedurës bien në barrë të mjeteve buxhetore .

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren ka paraqitur aktakuzën PP/II.nr.264-13/22 të dt.20.06.2022, ndaj të pandehurit N. (Ç.)V. nga Prizreni, për shkak të veprës penale, Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par. 1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin fillestar me datën 06.03.2024 me ç 'rast i pandehuri, i ka propozuar gjykatës që kjo çështje penale të dërgohet në procedurë të ndërmjetësimit.

Prokurori shtetit nuk ka kundërshtuar propozimin e të akuzuarit, që çështja penale të dërgohet në procedurë për ndërmjetësim.

Gjyqtari i vetëm gjykues e ka aprovuar propozimin e të pandehurit dhe me këtë aktvendim i ka udhëzuar palët në procedurë të ndërmjetësimit.

Me datën 06.03.2024, palët në procedurë të ndërmjetësimit kanë zgjedhur këtë çështje penale me marrëveshje për ndërmjetësim.

Andaj gjykata bazuar në provat e cekura më lartë dhe në bazë të nenit 248 par.1 nën par1.4 të KPPRK-së dhe nenit 12 paragrafi 12.5 Ligji për Ndërmjetësim vendosi si në dispozitiv të aktvendimit.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL
P.nr.621/2022 datë 26.03.2024**

G j y q t a r i

Refki Piraj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesë.